



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDREYSHE**

08 dhjetor 2016, Prizren

**KOMUNIKATË PËR MEDIA
Parku i qytetit të revitalizohet për rekreacionin e të gjitha kategorive të shoqërisë**

EC Ma Ndryshe dhe OPMDK në Prizren kanë publikuar raportin e vizionimit dhe kanë realizuar performancën publike "Parku i qytetit për të gjithë".

Pas konsultimeve disa mujore me grupe të ndryshme të PAK dhe qytetarët shfrytëzues të rregullt të parkut, është hartuar vizioni për revitalizimin e Parkut të qytetit dhe adaptimin e kësaj hapësire të gjelbër publike për nevojat e PAK.

Në kuadër të performancës publike janë prezantuar kërkesat që dalin nga vizionimi për intervenime si për krijimin e trotuareve të qasme për të gjithë, rampave të reja të shkallët ekzistuese dhe të ura, tualeteve për PAK të tualeti publik ekzistues, hapësirave të lodrave për të gjithë fëmijët, fushës multifunktionale, parkingut për PAK, ulëseve për të gjithë, etj.

Për më tepër informata në lidhje me vizionimin për Parkun e Qytetit shkarkoni raportin e plotë në linkun:http://ecmandryshe.org/repository/docs/161208123218_RAPORTI_I_PUNETORISE_SE_VIZIONIMIT_PARKU_I_PRIZRENIT_RBASHA.pdf

Publikimi i raportit të vizionimit dhe realizimi i performancës publike "Parku i qytetit për të gjithë" janë realizuar në kuadër të projektit "Prizreni, një qytet pa pengesa". Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti përfshinë ngritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara dhe të rinjve në projektimin e "Prizrenit pa pengesa".

Me respekt,

Valon Xhabali, Koordinator Programi

OJQ EC Ma Ndryshe

Saraqët 5, 20000 Prizren

Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-.5, 10000 Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

*Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit **Prizreni, një qytet pa pengesa**, që përkrahët financiarisht nga USAID, programi E4E dhe mbikëqyret nga ATRC.*



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

